



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës**  
 Ministarstvo za Kosovske Bezbednosne Snage / Ministry for the Kosova Security Force

**Departamenti i Personelit/ Odsek za personal/Department for Personnel**

Në mbështetje të nenit 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Kreu III, Neni 11 i këtij Ligji, Neni 15 i Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës shpall këtë:

**KONKURS**

<b><u>Titulli i vendit të punës:</u></b>	<b><u>Teknik Administrativ</u></b>
<b>Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës:</b>	<b>Grada CS-4</b>
<b>Nr. referencës së vendit të punës:</b>	<b>0382</b>
<b>Vendi:</b>	<b>MFSK</b>

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Ofron shërbime mbështetëse për Njësinë Mbështetëse të MFSK-së.
- Kujdeset për fotokopjimin e materialeve dhe dokumentacioneve të nevojshme.
- Dorëzon shkresat dhe shtypin ditor tek departamentet/zyrat tjera në institucion.
- Shpërndan materialin shpenzues për departamentet/zyrat e MFSK/FSK-së.
- Kryen shërbime të vozitjes për personelin e MFSK-së sipas nevojës.

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:**

- Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët posedojnë aftësi të plota për të vepruar dhe të drejta civile dhe politike, të cilët kanë përgatitje të nevojshme arsimore dhe aftësi profesionale për kryerjen e detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative dhe të cilët kanë aftësi fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.
- Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës mund të kryhet deri në një (1) vit para moshës së pensionimit.

**Proceduarat e konkurrimit:**

- Konkursi është i hapur për të gjithë të interesuarit për aplikim.

**Shkollimi i kërkuar:**

- Shkolla e mesme.
- Patentë shoferi të vlefshëm.

**Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen:**

- Përvojë si teknik administrativ në ministri; agjenci/organizatë ndërkombëtare apo ndërmarrje private.
- Njohuri kompjuterike.
- Njohuri të gjuhës shqipe apo serbe.
- Gjuha angleze (e dëshiruar).
- Tekniku duhet të jetë profesional, me përvojë dhe i besueshëm si dhe i aftë që t'i kryejë në mënyrë profesionale detyrat e dhëna sipas mandatit dhe ato shtesë brenda periudhës së pranueshme kohore.
- Duhet të ketë shkathësi të mira organizative.
- Duhet të përdorë maturinë në detyrës dhe gjatë punës me njerëz.
- Duhet të jetë i motivuar dhe me etikë të lartë pune.
- Ai/ajo duhet të posedojë aftësi që të punojë i/e mëvetësishme si dhe të punojë në ekip me punonjës të tjerë në përmbushjen e detyrave të dhëna.

**Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:**

- Procesi i rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës është i bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.
- Bazuar në aktet ligjore të lartpërmendura, kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e parapara do t'i nënshtrohen shqyrtimit fillestar të aplikacioneve të tyre.

- Konkurruesit më të suksesshëm do të përfshihen në listën e shkurtër dhe do të ftohen të marrin pjesë në testimin me shkrim dhe me gojë.
- Kandidatët që kalojnë testin me shkrim, do t'i nënshtrohen testit me gojë (intervistimit). Në fund të procesit përzgjedhës kandidatët e pazgjedhur kanë të drejtë ankese.

**Kohëzgjatja e emërimit:**

- Emërimi është me afat të pacaktuar, ndërsa kohëzgjatja e periudhës provuese është 12 muaj.

**Data e mbylljes së konkursit:**

- Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ditës së shpalljes së parë në të përditshmet kosovare.
- Data e fundit e aplikimit është 25.07.2012.
- Edhe aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

**Paraqitja e kërkesave:**

- Formularët duhet të dorëzohen në Departamentin e Personelit, personalisht apo të dërgohen me postë, në këtë adresë: **Ministria e FSK-së, Lagja Emshiri 1, 10000 Prishtinë, Departamenti i Personelit/Spektori i Rekrutimit, Kati II, zyra 216 (Ish-ndërtesa e Shtabit të Përgjithshëm të TMK-së)**, Prishtinë, në çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim.
- Kandidatët duhet t'ia bashkëngjitin aplikacionit kopjet e dokumenteve të nevojshme personale dhe kopjet e dokumenteve që dëshmojnë për kualifikimet e tij/saj. Dokumentet e pranuar nuk kthehen!

**Kërkesa specifike:**

- Kjo pozitë i nënshtrohet procesit të verifikimit dhe mund të plotësohet vetëm pas përfundimit të suksesshëm të procesit të verifikimit.

**Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore të të komuniteteve në Kosovë. Komuniteti joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë përfaqësimi proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, ashtu siç specifikohet në nenin 11. [paragrafin 3 të Ligjit nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës . Kërkesat e pakompletuara dhe të dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Formularët për aplikim janë në dispozicion në Departamentin e Personelit të M-FSK-së dhe në ueb-faqen e M-FSK-së, [www.mksf-rks.org](http://www.mksf-rks.org) , [www.rks-gov.net/mfsk](http://www.rks-gov.net/mfsk), ku gjendet shpallja e konkursit. Për informata plotësuese mund të kontaktoni në: 038 200 13 508.**